



REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVO/ REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI PROKURORIAL I KOSOVËS/ TUŽILAČKI SAVET KOSOVA/KOSOVO PROSECUTORIAL COUNCIL

KPK/Nr. 422/2017
Datë: 22 gusht 2017

Këshilli Prokurorial i Kosovës në bazë të nenit 4 paragrafit 1.26 të Ligjit Nr.03/L-224 për Këshillin Prokurorial të Kosovës dhe në bazë të nenit 35 paragrafit 2 të Rregullores Nr.10/2015 për Organizimin dhe Veprimtarinë e Këshillit Prokurorial të Kosovës, mori këtë:

VENDIM

- I. Themelohet Komisioni Ad Hoc për Rishqyrtimin e kërkesës së z. Hilmi Zhitia, të datës 01.08.2012, në këtë përbërje:
 1. Bahri Hyseni, Kryesues;
 2. Ikramije Bojaxhiu, anëtare dhe
 3. Arben Ismajli, anëtar.
- II. Obligohen anëtarët Komisionit për Rishqyrtim që detyrat dhe përgjegjësitë e tyre t'i ushtrojnë në bazë të legjisllacionit në fuqi.
- III. Obligohet Sekretariati që këtë Vendim ta publikojë në faqet zyrtare të KPK-së dhe PSH-së.
- IV. Vendimi hyn në fuqi ditën e nëshkrimit nga Kryesuesi i Këshilli Prokurorial i Kosovës.

A r s y e t i m

Me datë 04 gusht 2017 e kemi pranuar Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit me numër AA.nr.46/2017 të datës 18.07.2017 me të cilin është vërtetuar Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.1623/2012 i datës 10.10.2016.

Me të dy aktgjykimet është aprovuar si e bazuar kërkespadija e paditësit, Hilmi Zhitia, ndërsa është anuluar aktvendimi i të paditurit-Këshilli Prokurorial i Kosovës, nr. KPK/239/2012 i dt. 16.11.2012 dhe çështja i është kthyer në rishqyrtim dhe rivendosje të paditurës.

Këshilli duhet të rivendosë lidhur me çështjen, sepse Vendimi i Këshillit nr. **KPK/239/2012** është anuluar nga Gjykata e shkallës së dytë dhe kur gjykata e anulon aktin, kundër të cilit ka filluar

konflikti administrativ, lënda kthehet në gjendjen në të cilin ishte para se të ishte nxjerrë akti i anuluar.

Andaj në pajtim me Ligjin Nr.03/L-224 dhe rregulloren Nr.10/2015, Këshilli themeloi Komisionin i cili do ta ri-shqyrtojë kërkesën e z. Hilmi Zhitija, ish Kryeprokuror i Shtetit, të datës 01.08.2012.

Ky komision konstatimin e tij do ta paraqesë në takimin e 137 të KPK-së, spese vendimi i KPK-së për rivendosje të çështjes duhet të merret para datës 04 shtator 2017, në mënyrë që të përmbushet afati ligjor sipas nenit 65 të Ligjit për Konfliktet Administrative.


Blerim Isufaj
Kryesues i Këshillit Prokurorial

T'i dërgohet:

- Anëtarëve të Komisionit;
- Sekretariatit dhe
- Arkivit të KPK-së.